

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **656-25-2630-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Terheqja e mjeteve motorike me auto-terheqes Merimange**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	AUTO SALLON ARON SH.P.K.
NUI	811947251
Adresa	Rr. Brahim Ademi
Vendi	Ferizaj
Kodi postar	70000
Numri Telefonit	+383 44931487
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Valtrin Rexhaj
Adresa elektronike	autosallonaron@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	17.04.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Terheqja e mjeteve motorike me auto-terheqes Merimange

Nr i prokurimit: 656-25-2630-2-2-1

Titulli: Terheqja e mjeteve motorike me auto-terheqes Merimange

Data e njoftimit: 02.04.2025

Afati për dorëzimin e ofertave: 22.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesë për rishqyrtim për kritere: 07.04.2025

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim: 14.04.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 - PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I

ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, (Versioni i Konsoliduar)

Neni 1 i LPP-se

Neni 7 i LPP-se

Neni 28 i LPP-se

RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E

RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Për këtë aktivitet prokurimit, pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, ne si OE - palë e interesuar për pjesëmarrje në këtë tender, kemi hasur në kritere që personat/Grupet punuese të cilët kanë përgatitë Specifikimet Teknike/Termat e Referencës të AK KOMUNA FERIZAJ kanë vendosur kushte dhe kërkesa të cilat janë në kundërshtim me Ligji Nr. 04/L-042 - PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, (Versioni i Konsoliduar).

Perpilimi i kushteve dhe kritereve duhet të bëhet në përputhje me qëllimin dhe të drejtat në siguri të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar dhe tenderuesit, gjithmonë në përputhje me standardet e aplikueshme sipas ligjit.

Sipas Nenit 7 të LPP-së, paragrafi 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Konform nenit 28 paragrafi 2 të LPP-se, Autoriteti Kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operator ekonomik.

Sipas nenit 17.17 të Rregullores nr 002/2024, Dosja e Tenderit do të përgaditet në mënyrë që:

- a) Nuk kufizon konkurrencën në mesin e OE,
- b) Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Lidhur me Kërkesat/Kriteret në Dosjen e Tenderit të cilat janë në kundërshtim me nevojat e projektit dhe Ligjin për prokurim publik dhe rregullat dytesore, kërkojmë që:

Kriteri 1:

Sipas Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kapaciteti teknik dhe professional: **Lista e puntoreve se paku 6 puntore ku tre prej tyre te jene te certifikuar si operator vinci teleskopik dhe 1 shofer me kategori C.** Dëshmia e kërkuar dokumentare: **Lista e stafit e nenshkruar dhe e vulosur ne origjinal nga OE. Çertifikatat e stafit te deshmohen me kopje si dhe patentshoferi, kontrata te punes valide ose marreveshje mbi angazhim.**

Kriteri "**tre prej tyre te jene te certifikuar si operator vinci teleskopik**" është kriter që favorizon një kompani të caktuar, sepse tre operatorët e certifikuar si operator vinci teleskopik përdoren për punë me vinç (kran) teleskopik "Tower Cranes" që përdoret për ndërtimin e objekteve të larta ndërtimore. Vinci teleskopik montohet afër objektit që duhet të ndërtohet dhe si i tillë nuk ka të bëjë fare me natyrën e kontratës. Ky kriter favorizon një kompani të caktuar që posedon persona të certifikuar si operator vinci teleskopik dhe e kufizon pjesëmarrjen e shumë Operatorëve Ekonomik në këtë tender. Ky është kriter shumë specifik dhe nuk ka të bëjë fare me natyrën e kontratës dhe duhet të largohet nga kriteri që duhet të plotësohet nga OE tenderues.

Kriteri 2:

Sipas Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kapaciteti teknik dhe professional: **Lista e mjeteve te punes Se paku dy kamion per bartjen e automjeteve me peshe bartese mbi 3t te licencuar nga MMPHI; 1 Kamion me kran per bartjen e automjeteve me pesh ngritese te kranit jo me pak se 5t me testim; 1 Kamion per bartjen e automjeteve me pesh bartese ne dysHEME dhe ne cikrik terheqes jo me pak se 4 t me testim.;** Dëshmia e kërkuar dokumentare: **OE duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me Librezat e qarkullimit . OE duhet te ofroj per te gjitha automjetet e kerkuara me testime, certifikatat per kontrollime dhe testime sipas standardeve EN 14439 dhe EN 13586 . Çertifikatat e testimeve duhet te jene kopje valide. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

2.1 Kriteri për plotësimin e mjeteve të punës që specifikohen në këtë kriter, të gjithë kamionët e kërkuar e tejkalojnë peshën bartëse mbi 3 ton, 4ton, 5ton, ndonëse të gjitha automjetet që duhet ngarkuar në kamion është shumë më e ulët se pesha minimale e kërkuar.

Ju lutem që kriterin e përcaktimit të peshës bartëse ta largoni në tërësi dhe certifikimi i kamionëve nga MMPHI të mbetet pa e specifikuar sipas peshës ose peshën ta ndryshoni me peshë bartëse min. 1 ton.

2.2 Standardet e kërkuara EN 14439 dhe EN 13586 për plotësimin e kësaj kriteri (tek pjesa e Dëshmia e kërkuar dokumentare) , janë standarde që nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e kontratës. Këto standarde janë për vinça (kran) që përdoren për ndërtimin e objekteve ndërtimore.



Standardi EN 14439 për ndërtimin e "vincit teleskopik" kërkesë kjo për plotësim kriteri.

Me kërkim në internet dhe Standardi EN 13586 nuk ka të bëjë fare me natyrën e kontratës. Ky standard është veçanërisht i vlefshëm për:

- Kompanitë e ndërtimit: Sigurimi që të gjitha operacionet e vinçave të kryhen në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me rregulloret më të fundit.
- Inxhinierët dhe Dizajnuesit: Ofrimi i udhëzimeve të detajuara për të përfshirë zgjidhjet e aksesit të sigurt në modelet e vinçave.
- Inspektorët e sigurisë: Sigurimi i një standardi për vlerësimin e sigurisë së pikave dhe procedurave të hyrjes së vinçit.

Ju lutem ti largoni këto dy standarde sepse nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e kontratës. Sipas kërkesës për plotësim të këtij kriteri lehtësisht mund të konkludohet se është kriter që favorizon një kompani të caktuar dhe e kufizon pjesëmarrjen e shumë OE në këtë tender. Ju lutem ta largoni këtë kriter në tërësi.

Përfundim

Kriteri 1 dhe Kriteri 2 si në përshkrimin e kësaj "Kërkese për rishqyrtim" janë diskriminuese, që nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e kontratës dhe e kufizon pjesëmarrjen e shumë OE në këtë tender, ndërsa nëse nuk ndryshohen (hiqen) janë kritere që e favorizojnë një kompani të caktuar.

Ju lutem që këto kritere të ndryshohen sipas kërkesës që të na mundësohet pjesëmarrja në këtë tender.

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime materiale për përgatitjen e:

- Kërkesës për Rishqyrtim të kritereve;
 - Tenderimin;
 - Kërkesën për rishqyrtim ndaj Vendimit;
 - Ankesën;
 - Fitimin e pritur;
 - Vlerë të referencave
- të gjitha këto në shumë totale prej 45,000.00 Euro.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*